



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVO



Kuvendi Komunal Dragash – Skupština Opštine Dragaš – Municipality of Dragash
Drejtorati për Inspekcion, Bujqësi, Pylltari, Turizëm dhe Zhvillimit Rural
Direktorijati za Inspekciju, Poljoprivredu, Turizam, Šumarstvo i Ruralni Razvoj
Directoratë for Inspections, Agriculture, Tourism, Forestry and Rural Development

DATË/A	05/12/2023
REFERENCË/A	09Nr. 023/03 - 32267/23
PËR	Zyra për marrdhënie me publikun
CC	z. Bexhet Xheladini, Kryetar i Komunës
PËRMES	Zyra për Informim K.K Dragash
NGA	Erdjan Limançe – Drejtor i Inspekcionit
TEMA	Njoftim

Duke u bazuar në autorizimet e Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, me qëllim të mbrojtjes së Konsumatorëve, Shërbimi i Inspekcionit pranë K.K Dragash nxjerrë këtë:

NJOFTIM

Duke u bazuar në ankesat e shumta e të bazuara të konsumatorëve, KËRKOJMË nga operatorët ekonomik të cilët afarizmin e tyre e kryejnë në territorin e Komunës së Dragashit që:

- Pas verifikimit, të pranojnë të gjitha llojet e kartëmonedhave dhe monedhave zyrtare EURO, përfshirë edhe ato metalike të të gjitha llojeve e që nuk janë të falsifikuara, Ngase : Asnjë autoritet tjetër nuk mund të vendos për ndalimin ose lejimin e asnjë instrumenti të ligjshëm të pagesave, përveç BQK-së (Banka Qendrore e Republikës së Kosovës),
- Të largojnë menjëherë nga ç' do hapësirë reklamimet se nuk pranojnë kartëmonedha apo monedha metalike apo se pranojnë vetëm një shumë-sasi të caktuar, përveç mbishkrimeve me qëllime informuese nga institucione zyrtare,
- Operatorët ekonomik, qytetarët, në rast të paqartësive rreth kartëmonedhave, monedhave, t'u referohen vetëm rekomandimeve zyrtare nga BQK, bashkangjitur në këtë link: <https://bqk-kos.org/edu/materialet/monedhat-euro/>,
- Në raste të shkeljeve ligjore nga ana e ç' do operatori, konsumatorët të drejtohen në: Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit,

Telefoni pa pagesë, nga të gjithë operatorët mobilë dhe telefoni fiks: **0800 11000**, ose <https://konsumatori.rks-gov.net/>